


Janë silantet produkte të reja?

Jo, silantet janë në përdorim që nga viti 1960. Studime të ndryshme kanë ndikuar në zhvillimin e silanteve dhe kanë demonstruar që janë të sigurt dhe efektiv. Shumë njerëz akoma nuk kanë informacion mbi silantet.

A ka forma të tjera përveç silanteve për të parandaluar kariesin?

Po. Përdorimi i pastës dhe shplarjeve të fluorizuar ndihmon në parandalimin e prishjes së dhëmbëve. Uji në Shqipëri nuk është i fluorizuar, për këtë arsye dentisti do ju rekomandojë fluor në trajtë xheli, tabletë ose solucion shpëlarës. Fluori është mbrojtja më e mirë kundër kaviteteve.



Fluori:

- Rrit rezistencën e dhëmbëve ndaj kaviteteve
- Riparon sipërfaqet e vogla të prishura, përpara se të kthehen në kavite të mëdha
- Ul fuqinë e bakterieve për të shkaktuar karies

Fluori ndihmon më shumë në sipërfaqet e lëmuara, është më pak efektiv në sipërfaqet okluzale të dhëmbëve të pasëm. Larja e rregullt e dhëmbëve me furçë dhe pastë të fluorizuar ndihmon në parandalimin e kaviteteve.


Silantet së bashku me fluorin parandalojnë pothuajse të gjitha prishjet e dhëmbëve.



Silantet të ndihmojnë në mbrojtjen e dhëmbëve nga prishja

Ku mund ti aplikoj silantet për fëmijët e mi?

Konsultohuni me dentistin tuaj. Ndonjëherë silanimiti aplikohet dhe në shkollë.



SHOQATA DENTARE SHQIPTARE

**MBRONI DHËMBËT
me silante**

FLETËPALOSJE PËR PRINDËRIT



www.shdsh.org

Çfarë janë silantet?


Silantet janë veshje plastike të holla të aplikuara në sipërfaqet përtpëse.

Silantet aplikohen nga dentisti. Aplikimi i silanteve është jo i dhimbshëm dhe i thjeshtë. Silantet aplikohen në trajtë likidi, ngurtësohen duke formuar një shtresë mbrojtëse mbi sipërfaqen dhëmbore.



Si aplikohen silantet?


Proçedurat që ndiqen janë:



1 Pastrimi i dhëmbit.

2 Tharja e dhëmbit dhe vendosja e tamponave të pambukut përreth dhëmbit.

3 Aplikimi i një solucioni që ashpëron pak sipërfaqen e dhëmbit, i cili lehtëson ngjitjen e silantit.



4 Shpëlarja dhe tharja e dhëmbit, vendosja e tamponave përreth për ruajtjen e thatësisë.

5 Silantet aplikohen në trajtë likide dhe fortësohen për pak sekonda.

6 Silantet vendosen në sipërfaqet okluzale.

Përse aplikohen silantet?

Arsyeja kryesore e aplikimit të silanteve është parandalimi i prishjes së dhëmbëve. Fluori në pastat e dhëmbëve mbron sipërfaqet e lëmuara të dhëmbëve, por dhëmbët e pasëm kanë nevojë për mbrojtje shtesë. Silantet mbushin të thelluarat në sipërfaqet përtpëse duke eliminuar grumbullimin e mbeturinave ushqimore dhe bakterieve.

Aplikimi i silanteve kursen kohë dhe para, të cilat nevojiten për riparimin e dhëmbëve të prishur si psh: mbushjet, kurorat etj.

Çfarë shkakton prishjen e dhëmbëve?

Bakteriet në gojë shfrytëzojnë sheqernat në ushqime dhe prodhojnë acide. Me kalimin e kohës, acidet ndikojnë në formimin e kaviteteve. Dhëmbët e pa prishur janë të shëndetshëm. Prandaj duhet të parandalojmë prishjen e tyre. Kjo është arsyeja që silantet janë kaq të rëndësishëm.

Pse dhëmbët e pasëm prishen kaq lehtë?

Sipërfaqja përtpëse e dhëmbëve të pasëm është e ashpër si rrjedhojë e thellimeve dhe gropëzave. Bakteriet dhe mbeturinat ushqimore mund të ngecin në to, duke qëndruar për një kohë të gjatë dhe qimet e furçës nuk mund ti eliminojnë ato.

Kush mund të përdori silantet?

Fëmijët duhet të silanojnë dhëmballët e përhershëm sapo dalin-përpara shfaqjes së kariesit. Dhëmballa e parë e përhershme del ndërmjet moshës 5 dhe 7 vjeç. Dhëmballa e dytë e përhershme del ndërmjet moshës 11 dhe 14 vjeç. Dhëmbët të tjerë me thellime dhe gropëza mund të kenë nevojë për silanim. Adoleshentët dhe të rinjtë që kanë prirje për karies mund të kenë po ashtu nevojë për silanim.

Duhet të aplikohen silantet në dhëmbët e fëmijëve?

Dentisti juaj do ju këshillojë si të veproni. Në dhëmbët e qumështit që kanë thellime dhe gropëza të mëdha, aplikimi i silantit është shumë i rëndësishëm. Dhëmbët e përkohshëm ruajnë hapësirat për dhëmbët e përhershëm dhe është e rëndësishme të parandalohej heqja e parakohshme e tyre.

Sa kohë zgjasin silantet?

Silantet mund të zgjasin nga 1-10 vjet, por duhet të kontrollohen vazhdimisht tek dentisti, që të mos ketë rënie të pjesshme ose të plotë të tyre. Në raste të tilla, dentisti riparon silantet.



Çfarë ndodh nëse një kavitet i vogël, mbulohet rastësisht me silant?

Në keto kavitate kariesi mund të mos përhapet, sepse ndërpritet furnizimi i vazhdueshëm me ushqime dhe bakterie.